



# NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C.

Part of BALFIN, Balkan Finance Investment Group

## NJOFTIM PUNE

**Balfin Group** është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitetet për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e hapsirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

NewCo Ferronikeli Complex L.L.C është pjesë e Balfin Group dhe operon në sektorin e Industrisë së Minierave.

**Pozicioni:** Inxhinier Projektues  
**Departamenti:** Mirëmbajtje  
**Lokacioni:** Drenas, Kosovë

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Realizimi i vizatimeve dhe projekteve të ndryshme dhe ofrimi i alternativave.
- Është përgjegjës direkt për organizimin e procesit të zbatimit të projektit deri në momentin e dorëzimit të punimeve.
- Është përgjegjës për mënyrën, formatin dhe efikasitetin e komunikimit me klientin, në fazën e zbatimit të projektit, veçanërisht në lidhje me ndryshimet që kërkon klienti, të cilat bëhen gjatë procesit të zbatimit.
- Mban kontakt të vazhdueshëm me palën tjetër dhe komunikon tek Menaxhmenti të gjitha kërkesat e palës tjetër.
- Organizon grupin e montimit duke i komunikuar me shumë saktësi detajet, procedurat dhe radhën, mënyrën dhe kohën e montimit të materialeve, sipas grafikut të punimeve.
- Dorëzon raporte ditorë, javorë, mujorë, të shoqëruar me pamje të objektit, informacion të detajuar mbi procesin e punës, kartela të projektit, etj.
- Ndjek ecurinë e punëve në fabrikë, bashkëpunon dhe raporton për zbatim të projekteve.

### Kualifikimet dhe Aftësitë

- Fakulteti i Inxhinierise Mekanike, profili Konstrukione dhe Mekanizim.
- Përvojë pune së paku 5 vite në pozicione të ngjashme.
- Të ketë njohuri shumë të mira kompjuterike: Microsoft Office, Autocad, Microsoft Project.
- Shkathësi të mira komunikuese dhe organizative.
- Duhet të ketë njohuri të mira të Gjuhës Angleze (obligative).

### Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV-të e tyre së bashku me letër motivimi dhe dokumentet përcjellëse më së largu deri më 15/02/2020, në adresën e e-mailit [hr@ferronikeli.com](mailto:hr@ferronikeli.com) duke përcaktuar në subjekt pozicionin "**Inxhinier Projektues**".

\*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe vetëm kandidatët që do të përzgjedhen në listen e ngushtë do të kontaktohen.

